

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin***Tetor, 2019**

Takim zgjedhor i Forumit të gruas në SBASHK

Vlora Berisha Rexhepi kryetare e këtij forumi

Në ambientet e Qendrës së studentëve është mbajtur takimi zgjedhor i forumit të gruas në SBASHK. Në fillimet e këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka folur për angazhimet e bëra dhe për rolin e femrës në këtë sindikatë duke kujtuar se në sistemin e arsimit sa vjen e shtohet numri i femrave të punësuar dhe se në SBASHK femra është e përfaqësuar kudo që nga Kongresi me 50 % te delegatëve, në Këshillin Drejtues, në të cilin 40 % janë femra dhe në kryesi e stafin qendror. Kryetari, para se t'i uronte punë të mbarë ... (faqe 4)

Puna dhe përkushtimi vlerësohet e çmohet nga të gjithë

Të gjitha universitetet bashkë e në SBASHK



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ... (faqe 10)

Intervistë me Vlora Rexhepi Berisha, kryetare e forumit të gruas në SBASHK



Vlora Rexhepi Berisha ka vite që është ... (faqe 3)

Aktivitet i veçantë dhe shumë i suksesshëm i SBASHK-ut

Përgatiten kuadro të reja për 5 trajnimet e licencuara



Trajnimet e licencuara të SBASHK-ut nga Këshilli Shtetëror ... (faqe 8)

Vazhdojnë aktivitetet e SBASHK-ut në shumë komuna të Kosovës

Përkushtim e angazhim edhe gjatë gjithë vikendeve



Të shtunat dhe të dielat nuk janë më ditë pushimi për shumë ... (faqe 5)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Tre tetori solli një lajm të veçantë për të gjithë ne



Viti i kaluar shkollor me të drejtë është konsideruar si nga më të vështirët dhe i përcjellë me shumë sfida. Greva unike për tri javë rresht e SBASHK-ut ishte kthyer në temë kyçe të aktualitetit dhe ishin hapur shumë debate. Greva solli arritje dhe dëshmoi unitetin dhe gatishmërinë e SBASHK-ut për t'u përballur me sfidat e për të mbrojtur kërkesat legjitime. Sfidat vazhduan edhe pas grevës. Një vendim i pa bazuar në ligj i ish ministrit Bytyqi e që kishte të bënte me një urdhër për kompensimin e të gjitha orëve të grevës 3 javore ishte kundërshtuar nga SBASHK-u, që po mbronte vendimin e Këshillit Drejtues të kësaj sindikate që orët e humbura në grevë të mos kompensoheshin. SBASHK-u iu drejtua Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Administrative duke kërkuar drejtësi, por një gjykatëse duke u thirr në emocione, duke qenë edhe në presion nga një debat për orët e humbura në Parlamentin e Kosovës, i cili u shoqërua edhe me akuza të pabaza e me një fjalor

rrugësh të ndonjë deputeti, solli vendim që të mbështetet vendimi i ish ministrit Bytyqi. Ky vendim i gjykatës trimëroi disa Drejtori arsimore e disa drejtor shkollës, që nisen me presione nga më të ndryshmet, por mësimdhënësit e Kosovës qëndruan në vendimin Këshillit Drejtues dhe orët nuk u kompensuan.

SBASHK-u duke qenë arsyeshëm i pakënaqur me vendimin Gjykatës Themelore iu drejtua Gjykatës së Apelit të Kosovës me një ankesë në të cilën solli gjithë argumentet se Gjykata e shkallës së parë nuk ka nxjerr vendim të drejtë. Gjykata e Apelit ka sjellë aktgjykimin e saj duke miratuar ankesën e SBASHK-ut dhe duke prishur vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 552/2019, i datës 25.04. 2019. “Miratohet si e bazuar ankesa e paditëses SBASHK, ndërsa priset aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 552/2019, i datës 25.04. 2019 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje”, thuhet në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës. Ishte ky tre tetori, që solli një lajm të veçantë për të gjithë ne.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me Vlora Rexhepi Berisha, kryetare e forumit të gruas në SBASHK

Ndjehem krenare me besimin e kolegeve nga e tërë Kosova



Vlora Rexhepi Berisha ka vite që është e punësuar në stafin SBASHK-ut. Është dëshmuar me punë e përkushtim duke kontribuar në realizimin e detyrave të shumta të SBASHK-ut në përpjekjet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Me humorin e lehtë ndihmon në krijimin e

atmosferës pozitive. Ajo ndjehet krenare me besimin e kolegeve nga e tërë Kosova duke e zgjedhur kryetare të forumit të gruas. “SBASHK-un me kuptimin e plotë të fjalës e konsideroj se shtëpi të dytë”, thotë Vlora në intervistën për gazetën tonë.

Arsimimi sot:

Kush është Vlora Rexhepi Berisha?

Vlora:

Kam lindur në Prishtinë, ku edhe kam mbaruar shkollimin bazik. Më pastaj studimet në Universitetin AAB, Fakulteti Ekonomik, dega-Administrim Biznesi dhe Marketing në Prishtinë. Pas kësaj kam vazhduar me studimet për të arritur te titulli master i ekonomisë, dega-Menaxhimi i sektorit Publik pranë Kolegjit Universum. Jam e martuar, nënë e bekuar me tre çuna që më japin vullnet çdoherë.

Arsimimi sot:

Kur jeni punësuar në SBASHK ?

Vlora:

Jam e punësuar dhe jam anëtare në SBASHK që nga viti 2005. Me plotë fjalën mund të them se tani e konsideroj edhe si shtëpi të dytë. Jemi këtu një staf me numër të vogël, por përkushtimi dhe respekti ndaj punës , por edhe ndaj besimit që SBASHK-u gëzon kudo në Kosovë e me gjerë na jep forcë të punojmë e

angazhohemi në realizimin e detyrave tona. Shumë herë edhe i ndihmojmë njëri-tjetrit kur në një sferë paraqiten shumë detyra e kërkesa. Ndjehemi vërtet sikur jemi një familje.

Arsimimi sot:

Ka vite që përfaqësoni SBASHK-un në Komitetin për barazi në kuadër të ETUCE?

Vlora:

Po dhe ndjehem krenare me këtë. Në vitin 2016, pas Konferencës Rajonale të ETUCE- për Rajonin Evropian të Arsimit Ndërkombëtar, pas zgjedhjeve që janë bërë në këtë takim, kryesia e SBASHK-ut më ka emëruar përfaqësuese në Komitetin e ETUCE-së për Barazi, me mandat 4 vjeçar. Gjatë këtyre viteve deri më tani, kam pasur mundësinë të ndjekë takime të ndryshme, përveç atyre obligative të caktuara nga Komiteti. Nga këto takime, të gjitha të lidhura me temën mbi barazinë qoftë gjinore, racore, fetare etj kam fituar mjaft njohuri, përvoja dhe shembuj konkret, të cilat do të mundohem t'i bart te anëtarësia e SBASHK-ut. Kam vërejtur gjatë këtyre takimeve ndërkombëtare se SBASHK-u gëzon respekt nga udhëheqës të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës dhe kjo falë angazhimit, por edhe arritjeve të shumta që sindikata jonë ka shënuar si zë i vetëm dhe i vërtetë i punëtorëve të sektorin e arsimit, por edhe të kulturës dhe shkencës.

Arsimimi sot:

Respekti që keni krijuar bëri që të zgjedheni kryetare e forumit të gruas ?

Vlora:

Po. Në tetor të këtij viti, u formua Forumi i Gruas të SBASHK-ut ku edhe u mbajtur takimi i parë i këtij forumi. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj më nominoi për pozitën e kryetares së këtij forumi, për çka i jam shumë mirënjohëse për besimin dhe respektin. Po ashtu falënderoj edhe gjitha pjesëmarrëset që më zgjedhën kryetare të këtij forumi për besimin e tyre përmes votës së fshehtë .

Arsimimi sot:

Me kë do të nisni fillimisht iniciativat konkrete në shërbim të këtij forumi?

Vlora:

Në takimin zgjedhor të forumit janë zgjedhur me votën e lirë edhe anëtarët kryesisë të forumit, që vijnë nga pjesë të ndryshme të Kosovës dhe jam shumë e sigurt se bashkë Flutura Demaku Zariqi, Lindita Muja, Florie Rexhepaj, Marigonë Bytyqi, Fevzie Berisha, Arbneha Aliu dhe Diellza Mamusha do të shtrijmë angazhimet në tërë Kosovën për të qenë

pranë kolegeve tona të nderuara, që në arsim kanë kaluar 50 % të të punësuarve.

Arsimimi sot:

Një mesazh juaji ?

Vlora:

Një citat i huazuar: Kur gratë përkrahin njëra-tjetrën, ndodhin gjëra të jashtëzakonshme!

Gjatë muajit

Takim zgjedhor i Forumit të gruas në SBASHK

Vlora Berisha Rexhepi kryetare e këtij forumi



Në ambientet e Qendrës së studentëve është mbajtur takimi zgjedhor i forumit të gruas në SBASHK. Në fillimet e këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka folur për angazhimet e bëra dhe për rolin e femrës në këtë sindikatë duke kujtuar se në sistemin e arsimit sa vjen e shtohet numri i femrave të punësuar dhe se në SBASHK femra është e përfaqësuar kudo që nga Kongresi me 50 % të delegatëve, në Këshillin Drejtues, në të cilin 40 % janë femra dhe në kryesi e stafin qendror. Kryetari, para se t'i uronte punë të mbarë këtij takimi, ka kujtuar se në këtë aspekt janë shënuar arritje të mëdha. Ai ka përshëndetur pastaj edhe përfaqësuesit e BSPK-së që ishin mysafirë të këtij takimi.



Pas kësaj punimet e Forumit të gruas i ka udhëhequr nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala e ndihmuar nga sekretarja e përgjithshme, Jehona Oruqi. Nënkryetarja e SBASHK ka shpalosur planin e aktiviteteve të forumit dhe pastaj ka lexuar edhe Rregulloren e punës së forumit, që është aprovuar nga delegatet e këtij takimi.



Në pjesën e dytë të këtij takimi është kaluar në zgjedhjen e kryetares dhe kryesisë për të cilat funksione kanë garuar një numër i konsiderueshëm i punëtorëve të arsimit. Me qëllim që të jenë të përfaqësuar të gjitha pjesët e Kosovës në garë kanë marrë pjesë përfaqësuese nga të shtatë rajonet e Kosovës për të cilat është votuar përmes votës së fshehtë e në mënyrë demokratike.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Pas këtij procesi transparent janë numëruar votat për kryetaren dhe anëtarët e kryesisë së këtij forumi.



Me shumicë votash kryetare e Forumit të gruas në SBASHK është zgjedhur Vlora Rexhepi Berisha, e cila ka një përvojë të mirë në aktivitetet sindikale dhe ka përfaqësuar SBASHK-un edhe në takimet ndërkombëtare të grave sindikaliste të Evropës.

Përmes votës së lirë ka dalë edhe kryesia e këtij forumi: Flutura Demaku Zariqi, Lindita Muja, Florie Rexhepaj, Marigonë Bytyqi, Fevzie Berisha, Arbneha Aliu dhe Diellza Mamusha.

Vazhdojnë aktivitetet e SBASHK-ut në shumë komuna të Kosovës

Përkushtim e angazhim edhe gjatë gjithë vikendeve

Të shtunat dhe të dielat nuk janë më ditë pushimi për shumë anëtarë të SBASHK-ut. Ata janë bërë pjesë e trajnimeve "Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social", "Udhëheqja dhe Planifikimi Strategjik në Arsimin Parauniversitar", "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik", "Aplikimi i Programeve Kompjuterike në Mësimdhënie" dhe "Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për Ciklin Fillor dhe të Mesëm".



Kështu në Ferizaj me të përfunduar të trajnimeve të nisura në vikendet e kaluara është filluar me trajnimet e reja në këtë vikend. Për t'i përshëndetur e për t'i përgëzuar për angazhimin e tyre pjesëmarrësit dhe trajnerët e këtyre trajnimeve i kanë vizituar kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj i shoqëruar nga menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer

Ymeri dhe kryetari i SAF e SAM në Ferizaj, Rexhep Sadiku e nënkryetari Fejzulla Vranoci. Kryetari i SBASHK-ut ka folur për trajnimet dhe ka lavdëruar përkrahimin e pjesëmarrësve, ndërsa nga menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri u është përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve.



Trajnimit "Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social", është udhëhequr në Ferizaj nga trajneri Blerim Mehmeti, i cili është shprehur i kënaqur me angazhimin dhe arritjet që kanë shënuar kolegët tanë në këtë trajnim. Në këtë qytet është mbajtur edhe trajnimet "Udhëheqja dhe Planifikimi Strategjik në Arsimin Parauniversitar" me trajnerin Fidan Shaqiri, "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik" udhëhequr nga trajneri Hysen Hyseni



dhe "Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për Ciklin Fillor dhe të Mesëm".



Një interesim i madh për trajnimet po ndodh edhe në Gjakovë. Në këtë komunë ka kohë që janë duke u zhvilluar që të pesë trajnimet e licencuara nga SBASHK. Trajneri prof. dr. Hysen Sogojeva ka nisur me trajnimin "Udhëheqja dhe Planifikimi Strategjik në Arsimin Parauniversitar". Ai është shprehur se kudo gjendet me këtë trajnim në komunat e Kosovës ka parë një angazhim e përkushtim shembullor të pjesëmarrësve. Po në Gjakovë ka nisur edhe një grup në trajnimin "Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social". Trajneri Blendor Shatri po ashtu thekson se në Gjakovë, por edhe në komunat tjera pjesëmarrësit janë të përkushtuar dhe gjatë trajnimit janë aktiv duke e bërë që trajnimi të ketë rrjedhë dinamike.



Aktiviteti i trajnimeve ka gjetur shtrirje edhe në Prizren. Atje është nisur këtë vikend me trajnimin "Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social", udhëhequr nga trajneri Ramadan Gashi dhe trajnimi "Udhëheqja dhe Planifikimi

Strategjik në Arsimin Parauniversitar", udhëhequr nga trajneri Safet Beqiri.

Po gjatë vikendeve janë duke u mbajtur edhe vlerësimet e arritjeve nga trajnimi "Aplikimi i Programeve Kompjuterike në Mësimdhënie". Për të parë arritjet e dhe për të organizuar vlerësimin e njohurive kanë shkuar në Lipjan, Viti e Pejë kryetari Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, kurse në Mitrovicë nënkryetarja Vjollca Shala.



Në Lipjan përfaqësuesit e SBASHK kanë zhvilluar para vlerësimit të njohurive një bashkëbisedë me pjesëmarrësit lidhur aktivitetet dhe kanë dëgjuar edhe ide të angazhimeve në të ardhmen, kurse në Viti pjesëmarrësit e trajnimit ia ka vizituar kryetari i kësaj komune Sokol Haliti dhe Drejtorja e DKA-së, Fatbardha Emini. Ata kanë lavdëruar SBASHK-un për angazhimet dhe kanë shprehur gatishmërinë që edhe në të ardhmen të bashkëpunojnë dhe bashkërisht të kontribuojnë në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë. Drejtorja Emini ka shprehur respekt për punën e arritjen e punëtorëve të arsimit në këtë komunë duke shtuar se puna e tyre e përkushtuar vërehet edhe te arritjet e shumta dhe sukseset e nxënësve të Vitisë.

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i shoqëruar nga menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe kryetari i SAF e SAM të Pejës, Isuf Lajçi kanë vizituar pjesëmarrësit në trajnime në shkollat e qytetit e pastaj Jasharaj dhe Lajçi kanë vizituar shkollën "Dëshmorët e kombit" në Baran, të cilët janë duke përcjellë trajnimin "Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për Ciklin Fillor dhe të Mesëm" me trajnerët Adelina Selimi dhe Atdhe Hykolli.

Në Bruksel është mbajtur Konferenca “Migrimi dhe Edukimi”

SBASHK mes sindikatave nga e tërë Evropa



Organizuar nga Komiteti i Sindikatave Evropiane për Arsim(ETUCE) dhe Federata e Punëdhënësve të Arsimit (EFEE) dhe mbështetur financiarisht nga Komisioni Evropian është mbajtur në Bruksel Konferenca “Migrimi dhe Edukimi. Në këtë takim me rëndësi kanë marrë pjesë të gjitha sindikata e arsimit anëtare te ETUCE-s e në mes tyre edhe dy përfaqësues të SBASHK-ut .



Konferencën e hapi kryetarja e ETUCE-së, z.Christine Blover, e cila përshëndeti pjesëmarrësit dhe i informoj për temën e Konferencës, po ashtu edhe kryetari i EFEE Michael Moriarty, Susan Flocken ,drejtoreshë Evropiane e ETUCE-së,Daniel Visnievski, sekretar i përgjithshëm i EFEE, Riikka-Maria dhe Nihad Bunar,Jorg Tagger nga zyra qendrore e Komisionit Evropian për dialog social paraqiten rëndësinë dhe format e zhvillimit të dialogut social ne nivel Evropian. Konferenca vazhdoi punimet edhe ditën e nesërme ne objektin ne ndërtesës së Parlamentit të Komisionit Evropian. Fakti se ka

shumë popullatë të cilët nga arsye të ndryshme migrojnë nëpër vende të ndryshme të botës, kjo konferencë është mbajtur për ta gjetur rrugën më të mirë drejt shkollimit të emigrantëve.



Përfaqësuesit e SBASHK kanë pasur takime të shumta me kolegë sindikalistë nga vende të ndryshme të Evropës dhe kanë dhënë kontribut gjatë Konferencës.

Në pjesën e parë të konferencës u zhvilluan shumë debate rreth migrimit dhe edukimit, si dhe për dialogun social qe duhet të zhvillohet ne relacionin mësues, prind dhe nxënës,ndërsa pjesa e dytë është zhvilluar me punëtori të cilat u ndanë në tri grupe dhe zhvilluan biseda te ndryshme rreth kësaj teme duke dhënë edhe propozimet e tyre duke raportuar ne pjesën qendrorë të konferencës.



Pjesën përmbyllëse të ditës së parë e prezantuan drejtoresha e përgjithshme e ETUC-ës, znj. Susan Flocken dhe sekretari gjeneral z. Daniel Visnievski. "Për refugjatët, marrja e një arsimit është mënyra më e mirë për t'u bërë anëtarë të plota në vendet e tyre pritëse. Prindërit dhe fëmijët e tyre përfitojnë intelektualist dhe shoqërisht nga ndjekja e shkollës, ku mësojnë për shoqërinë në të cilën ata

jetojnë. Azilkërkuesit, në pritje të një vendimi për të ardhmen e tyre, kanë nevojë për kurse themelore gjuhësore - veçanërisht nëse ata janë të mitur të pashoqëruar. Për emigrantët pa dokumente, qasja në një arsim bazë siguron stabilitet dhe një pamje të rregullsisë në jetën e tyre, përveç rritjes së vetëvlerësimit" kanë kujtuar ata .

Aktivitet i veçantë dhe shumë i suksesshëm i SBASHK-ut

Përgatiten kuadro të reja për 5 trajnimet e licencuara



Trajnimet e licencuara të SBASHK-ut nga Këshilli Shtetëror i Licencimit të Mësimdhënësve "Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social", "Udhëheqja dhe Planifikimi Strategjik në Arsimin Parauniversitar", "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik", "Aplikimi i Programeve Kompjuterike në Mësimdhënie", "Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për Ciklin Fillor dhe të Mesëm" kanë zgjuar interesim shumë të madh të anëtarësia në të gjitha komunat e Kosovës . Kjo ka bërë që stafi udhëheqës i SBASHK-ut të organizojë një aktivitet të veçantë për të përgatitur kuadro të reja për të pesë trajnimet e licencuara. Si gjithmonë e në frymën demokratike e të transparencës së plotë SBASHK-u ka publikuar në ueb faqe ftesën , që ua ka mundësuar gjithë të interesuarve të konkurrojnë për detyrën e trajnerëve. Ishte saktësuar se ata duhet të jenë anëtarë të SBASHK-ut dhe të kenë përcjellë trajnimin gjegjëse dhe këtë ta kenë dëshmuar me certifikatën gjegjëse. Madje për ata që po aplikojnë për "Aplikimi i Programeve Kompjuterike në Mësimdhënie" u organizua edhe një vlerësim i njohurive të tyre. I është

dhënë kujdes meritues që pjesëmarrësit në këtë aktivitet të jenë nga të shtatë regionet e Kosovës.



Pasi janë bërë gjithë përgatitjet është filluar me një punëtori tre ditore me seanca plenare dhe pastaj edhe me punën në grupe sipas trajnimeve. Këtë aktivitet të veçantë dhe shumë të suksesshëm i SBASHK-ut e ka parë nga afër edhe Drejtori i Departamentit për Arsimin Parauniversitar në MASHT dhe kryetar i Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve, z. Alush Istogu, i cili ka përgëzuar SBASHK-un për këtë angazhim dhe për përgatitjen aq të mirë të këtij aktiviteti. Ai ka marrë pjesë aktive në këtë punëtori duke dhënë kontribut në sqarimin e shumë çështjeve dhe duke u përgjigjur në shumë pyetje të trajnerëve të ardhshëm. Drejtori Istogu ka vlerësuar lartë edhe përkushtimin e pjesëmarrësve , të cilët po vazhdonin përgatitjen për trajnerë aktivitetin edhe pas orarit të paraparë me agjendë e madje duke biseduar për tema konkrete edhe në kohë pauzash.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj në fillimet e kësaj punëtorie ka treguar për trajnimet e zhvilluara deri tani nëpër komunitetet e Kosovës duke theksuar se janë shtuar shumë kërkesat e anëtarëve të SBASHK-ut kudo në Kosovë për organizime të të pesë trajnimeve në komunitetet e tyre dhe kjo ka krijuar nevojën që të shtohet edhe numri i trajnerëve të licencuar, objektiv të cilën do ta arrijë ky aktivitet. Seancat plenare janë udhëhequr nga paneli, në të cilin përveç kryetarit Jasharaj dhe Drejtorit Istogu, ishin edhe nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala, sekretarja e përgjithshme Jehona Oruçi dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Për të ndihmuar rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti Alban Zeneli trajner i "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik" ka prezantuar në merr të gjithë trajnerëve aktual çështjet kyçe në të cilat do të fokusohen seancat plenare dhe puna në grupe.

Puna në grupe u ka mundësuar trajnerëve të pesë trajnimeve që të shpalosin detaje dhe të bashkëbisedojnë me trajnerët e ardhshëm për metodat dhe mënyrën sa më frytdhënëse të punës së trajnerit dhe komunikim dinamik e korrekt me pjesëmarrësit në trajnimet, në të cilat ata do të jenë trajnerë.



Punimet e grupit të trajnimit "Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social", i kanë udhëhequr trajnerët Rrahman Jasharaj, Ymer Ymeri e Blendor Shatri. Ky ishte nga grupet me numër të madh të pjesëmarrësve dhe hetohej një dinamikë e veçantë e angazhimit.

Me pjesëmarrësit në trajnimin "Udhëheqja dhe Planifikimi Strategjik në Arsimin Parauniversitar" kanë udhëhequr trajnerët Hysen Sogojeva dhe Jehona Oruçi, kurse te grupi "Edukimi Medial dhe Roli i tij në Zhvillimin Shoqëror dhe Demokratik" është angazhuar trajneri Alban Zeneli.





Një aktivitet plot dinamizëm është parë edhe te grupi "Aplikimi i Programeve Kompjuterike në Mësimdhënie", të cilin e kanë udhëhequr Vjollca Shala dhe Ymer Ymeri.



Puna dhe përkushtimi vlerësohet e çmohet nga të gjithë **Të gjitha universitetet bashkë e në SBASHK**

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me kryetarin e Sindikatës së Universiteteve në kuadër të SBASHK, Bardh Bardhi dhe zyrtari ligjor Blendor Shatri kanë pasur takime të ndara me të punësuarit në Universitetin "Fehmi Agani" të Gjakovës dhe me ata në Universitetin "Kadri Zeka" të Gjilanit. Këto takime janë organizuar duke shprehur dëshirën dhe gatishmërinë e të punësuarve në këto institucione të arsimit të lartë për t'u bërë pjesë e SBASHK-ut.

Një moment i veçantë nga kjo vizitë pune ishte takimi i delegacionit të SBASHK-ut me rektorin e Universitetit "Fehmi Agani", prof. ass. Dr. Artan Nimani. Ai ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim mes tij, stafit udhëheqës dhe SBASHK-ut duke përgëzuar z. Denis Spahija dhe të punësuarit këtu që janë bërë pjesë e SBASHK-ut.

Me grupin e trajnerëve të "Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për Ciklin Fillor dhe të Mesëm" janë angazhuar Adelina Selmani e Atdhe Hykolli.



Pjesëmarrësit në këtë aktivitet tre ditor do të tregojnë njohuritë e tyre në trajnimet gjegjëse duke qenë në cilësinë e trajnerit në njërin nga trajnimet e radhës nëpër komunat e Kosovës e pastaj do të certifikohen duke u bërë pjesë e trajnerëve të licencuar e duke u angazhuar pastaj nga stafi përgjegjës i SBASHK-ut në trajnimet gjegjëse.

Jasharaj, Bardhi dhe Shatri kanë falënderuar rektorin Nimani për mikpritjen dhe i kanë premtuar bashkëpunim korrekt dhe mbështetje të sindikatës në angazhimet në shërbim të arritjeve të reja në këtë institucion të arsimit të lartë.



Takimin në këtë Universitet e kishte përgatitur kryesuesi i Këshillit iniciues Denis Spahija., Ai ka përshëndetur mysafirët e takimit e pastaj ka shtuar se edhe të punësuarit e këtij institucioni të lartë arsimor kanë shprehur vullnetin për t'u bërë pjesë e SBASHK-ut ngase kanë vërejtur se kjo syndikatë është duke u angazhuar me përkushtim dhe se ka shënuar rezultate e arritje të konsiderueshme.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka uruar pjesëmarrësit që po i bashkohen SBASHK-ut e duke shtuar se ndjehet krenar që edhe Universiteti “Fehmi Agani” i Gjakovës erdhi bashkë e në SBASHK.

Kryetari i SUSHK-ut, Bardh Bardhi ka uruar kolegët e tij dhe ka kujtuar se numri i anëtarëve të SBASHK-ut ka universitetet, por edhe nga shkenca e kultura ka shënuar rritje të vazhdueshme dhe kjo shton forcën dhe angazhimet në SBASHK drejt arritjeve të reja. Ai ka kujtuar se një arritje e madhe, krahas 0.5 % për çdo vit shërbimi, Ligji i viteve të 90-ta, Korrigjimet në Ligjin e pagave , është edhe fakti se falë angazhimit maksimal u arrit të nënshkruhej Kontrata e Arsimit të Kosovës, në të cilën janë përfshirë edhe Universitetet.



Një takim pune është mbajtur edhe në ambientet e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjiilan .Këtë takim e ka udhëhequr kryetarja e Këshillit iniciues Minire Rexhepi, e cila ka shpalosur pjesë të angazhimeve dhe të bashkëbisedave me të punësuarit në këtë Universitet , të cilët duke parë angazhimin, përkushtimin e SUSHK-ut dhe arritjet e përbashkëta të SBASHK-ut kanë shprehur gatishmërinë që të jenë pjesë e kësaj syndikate që gëzon respekt kudo në Kosovë e më gjerë. Ajo në kuadër të fjalës hyrëse ka falënderuar për pjesëmarrje në këtë takim kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, kryetarin e Kuvendit të Syndikatave Universitare në kuadër të SBASHK-ut, Bardh Bardhi dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri. Duke shprehur respektin për punën dhe angazhimin e SBASHK-ut, sekretari i përgjithshëm i Universitetit të Gjilanit , z. Vaxhid Sadriu ka pritur në një takim përmbajtjesor delegacionin e SBASHK-ut duke zhvilluar një bashkëbisedë lidhur me arritjet e shumta që janë shënuar në këtë institucion arsimor dhe duke shprehur bindjen e përbashkët se me një bashkëpunim korrekt me syndikatën do të ketë angazhime të përbashkëta në shërbim të arritjeve edhe më të mëdha në këtë institucion arsimor.



Kryetari i SBASHK-ut, Jasharaj është shprehur i lumtur që edhe të punësuarit në Universitetin “Kadri Zeka” i bashkohen SBASHK-ut duke u shprehur se bashkërisht do të kenë angazhime dhe arritje të reja. Ai ka treguar pastaj edhe për angazhimet e arritjet që janë bërë dhe ka theksuar edhe faktin se në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës vend meritore zënë edhe Universitetet, të cilëve në të kaluarën u ka munguar fare Kontrata Kolektive. Jasharaj ka

lavdëruar punën e përkushtimit të kryetarit të Kuvendit të Sindikatës së Universiteteve, Bardh Bardhi, të kryesisë atje, por edhe të stafit të SBASHK-ut në qendër.

Kryetari i të Kuvendit të Sindikatës së Universiteteve, Bardh Bardhi bashkë me zyrtarin ligjor Blendor Shatri u janë përgjigjur pastaj shumë pyetjeve të pjesëmarrësve në këtë takim.

Pas kësaj anëtarët e SBASHK-ut në këtë institucion të arsimit të lartë kanë zgjedhur Këshillin iniciues, i cili do të vazhdojë me angazhimet dhe do të përgatit Kuvendin din zgjedhor të Sindikatës së Universitetit “Kadri Zeka”.

Në këtë Këshill iniciues janë zgjedhur : Minire Rexhepi, Refik Ibrahimimi, Kosovare Shabani, Ramize Veseli, Kushtrim Demi, Mensur Ajeti dhe Labinota Ramadani.

SBASHK edhe në një aktivitet të veçantë sindikal ndërkombëtar

Praktikat e sindikatave mbi mosdiskriminimin dhe diversitetin

Me ftesë nga Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Drejtësi dhe Konsumatorë (DPKEDK) në bashkëpunim me ETUCE edhe SBASHK-u, përfaqësuar nga Vlora Rexhepi Berisha mori pjesë në këtë konferencë për të shkëmbyer njohuri dhe përvoja në praktikat e sindikatave në lidhje me mosdiskriminimin dhe diversitetin.



Konferencën e hapi Drejtoresha Gjenerale e DPKEDK-së, Tiina Astola, e cila foli për qëllimin e kësaj konference.

“Në vitin 2010, Komisioni European zbatoi një studim i cili siguroi një pasqyrë të gjerë dhe të strukturuar ndërshtetërore të praktikave ose iniciativave më të rëndësishme dhe inovative, të zbatuara nga sindikatat, për të luftuar diskriminimin dhe për të promovuar barazinë dhe mundësitë e barabarta. Në vitin 2018, Komisioni European filloi një studim pasues që synon të kuptojë se çfarë lloje iniciativash po zbatohen në vendet e BE dhe në nivel evropian për të ndihmuar në luftën kundër diskriminimit dhe trajtimit të mëtejshëm të barabartë dhe atë që funksionon në sektorë të ndryshëm kombëtar, rajonal dhe sektorial kontekste. Studimi i vitit 2018 përqendrohet në diskriminimin në

bazë të besimit fetar ose personal, racës, përkatësisë etnike, orientimit seksual si dhe diskriminimit të shumëfishtë” ka kujtuar ajo.



Në këtë Konferencë u shpërndanë informacione në lidhje me praktikat e sindikatave në mosdiskriminim dhe diversitetin në vitet e fundit dhe u diskutuan rezultatet e fundit të studimit pasues mbi praktikat e sindikatave në mosdiskriminim dhe diversitet:

Konferenca është fokusuar në përgjigjet e pyetjeve :Cili është roli i sindikatave dhe çfarë ndikimi kanë në vendet e punës dhe shoqëri në mbështetjen dhe promovimin e diversitetit dhe mosdiskriminimit?, Cilat janë faktorët e suksesit dhe faktorët pengues që u mundësojnë sindikatave të zbatojnë në mënyrë efektive veprime për të nxitur diversitetin dhe mosdiskriminimin?, Cilat veprime janë më të suksesshme dhe të transferueshme nëpër sindikata dhe vende për të arritur qëllime të ndryshme dhe pse?, Si mund të mbështesë BE-ja sindikatat në mbështetjen dhe promovimin e diversitetit dhe mosdiskriminimit?